



BULETINI

Botimi Nr.

02

MUJOR MARS 2026

**01 MARS - BERLIN**

Nënshkruhet Deklarata e Përbashkët për mbështetjen e startup-eve

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, nënshkroi në Berlin një Deklaratë të Përbashkët për mbështetjen e startup-eve, inovacionit dhe lidhjen e ekosistemeve të biznesit.



07 MARS

Gëzuar Ditën 7 Marsin

Ministrja Ibrahimaj me rastin e Ditës së Mësuesit shprehu urimet dhe mirënjohjen për kontributin e 1700 mësuesve të arsimit profesional në formimin e të rinjve.



08 MARS

Gëzuar Ditën Ndërkombëtare të Gruas

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, zhvilloi një takim të hapur me gra sipërmarrëse ku ndanë bashkë sfidat, idetë dhe sukseset e tyre në rrugëtimin e biznesit.



KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I DRITARES SË VETME KOMBËTARE PËR DOGANAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Madër të Lehtësimit të Tregut dhe Transportit të Ballkanit Perëndimor

09 MARS

Prezantohet National Single Window

U prezantua Dritare e vetme digjitale për doganat, e cila synon të ulë burokracitë dhe përshpejton procedurat e import-eksportit për bizneset.



11 MARS

Monitorimi i Karburanteve

Në MEI u zhvillua takimi mes përfarqësuesve të Qeverisë dhe kompanive të hidrokarbureve për analizën e çmimeve në bursë dhe tregun vendas, duke synuar mbrojtjen e konsumatorëve.



11 MARS

Takim me Bankën Botërore

Zv.Ministrja Manjani zhvilloi një takim me ekipin e BB-së mbi reformat ekonomike, politikat fiskale dhe progresin drejt BE-së.



Ligji për shërbimet sjell rregullat e BE

në Shqipëri dhe hap tregun europian për profesionistët shqiptarë

11 MARS

Qeveria miraton ligjin për shërbimet

Këshilli i Ministrave miratoi ligjin për hartimit e politikave industriale dhe strategjisë për SME-të, si dhe diskutoi trajtimin e çmimeve të karburanteve.



13 MARS

Integrimi i biznesit në BE

Ministre e MEI, Ibrahimaj zhvilloi një takim me biznese të sektorit të përpunimit të mishit, ku diskutuan për përafrimin me standardet e BE-së dhe hartimin e projektligjit për produktet “Made in Albania”.



13 MARS

Mbrojtja e Konsumatorit

Zv.Ministri Enkelejd Musabelliu mori pjesë në tryezën mbi sfidat e mbrojtjes së konsumatorëve me pjesëmarrjen e shoqërisë civile, qeverisë dhe BE-së.



13 MARS

Mbrojtja industriale

Zv.Ministrja e MEI, Oltja Manjani, dorëzoi pranë WIPO (Gjenevë) instrumentin e ratifikimit të “Riyadh Design Law Treaty”, për të modernizuar mbrojtjen e dizajnit industrial.



18 MARS

Takim për Naftën

Në prani të Kryeministrit Edi Rama, u zhvillua në “Shtëpinë e Biznesit” një takim i posacëm për monitorimin e çmimeve të naftës dhe mbrojtjen e konsumatorëve.



18 MARS

Hapet në Tiranë panairi i punës

Ministrja Ibrahimaj mori pjesë në hapjen e Panairit të Punës, i cili ofroi mbi 7,500 vende të lira pune nga 80 biznese.



CEFTA

Central European Free Trade Agreement
SECRETARIAT

CEFTA 2026: Priorities and Work Program

Tirana, 18 March 2026


Hotel Tirana International



19 MARS

Prioritetet e CEFTA 2026

U prezantuan në Tiranë prioritetet për procedurat pa letra, tregtinë digjitale dhe lëvizjen më të shpejtë të mallrave në rajon.



**Edukimi Pas Shkollor në Shqipëri
Politika, Standarde dhe Modele për Zhvillim**
19.03.2026 | Tirana



19 MARS

Programi “After School”

Në një event të zhvilluar për programin “After School”, Ministria Ibrahimaj e vuri theksin mbi rëndësinë e aftësive praktike dhe mendimit kritik të të rinjve.



24 MARS

Mbështetja e Startup-eve

Ministrja Ibrahimaj nënshkroi një Memorandum me Bpifrance në Paris për të rritur aksesin në financime dhe projekte për startup-et shqiptare.



24 MARS

Konferenca EBRA

Zhvillohet në Tiranë takimi me partnerët evropianë për regjistrat e biznesit, duke theksuar progresin e Shqipërisë në digjitalizimin e shërbimeve.



25 MARS

Analiza e Inspektoratit të Punës

Prezantohet rezultati për vitin 2025, me fokus zero tolerancë ndaj informalitetit dhe forcimin e sigurisë në punë.



26 MARS

Forumi ekonomik Shqipëri–Japoni

Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, mori pjesë në forumin e dytë për promovimin dhe rritjen e investimeve japoneze në energji, turizëm dhe teknologji.



26 MARS

MatchMaker Albania 2026

Në prani të Kryeministrit dhe disa ministrave të kabinetit qeveritar event i ndërkombëtar bëri bashkë mbi 1,000 pjesëmarrës dhe 500 investitorë për të forcuar rritjen e investimeve në vend.



27 MARS

Bordi i Transparencës

Pas nisjes së luftës në Lindjen e Mesme, u mbledh për herë të parë Bordi i Transparencës i drejtuar nga Ministri Ibrahimaj, i cili përcaktoi çmimet maksimale me pakicë në 203 lekë/litër për gazoilin dhe 175 lekë/litër për benzinën.



27 MARS

Rritja Ekonomike 2025

Ministrja Ibrahimaj në një konferencë për shtyp bëri publike se rritja ekonomike vjetore prej 3.8% është mbështetur nga shërbimet, ndërtimi dhe reduktimi i papunësisë.



27 MARS

DIGITAL në Durana Tech Park

Krijimi i një parku teknologjik krijon një lidhje të re me ekosistemin evropian të inovacionit 28DIGITAL në Shqipëri.

Innovation4Albania

Një vizion i unifikuar për inovacionin
në sektorin publik dhe privat

Mars 2026 - Tiranë



27 MARS

Prezantohet Agjencia e Re e Inovacionit

Ministrja Ibrahimaj prezantoi krijimin e një strukture të re që bashkon AIE dhe Startup Albania për zhvillimin e inovacionit publik dhe privat.



29 MARS

Forumi Ekonomik Shqipëri–Kosovë

U zhvillua në Tiranë misioni i biznesit dhe nënshkrimi i një Memorandumi Bashkëpunimi mes AIDA-s dhe Odës Ekonomike të Kosovës, me fokus nxitjen e investimeve, heqjen e barrierave tregtare dhe zhvillimin e turizmit malor përmes takimeve B2B.